

Qendra kulturore e komunës së Medvegjës
Gjure Jakshiq 6
PIB: 110115115
NPR: 17907166
Xhirollogaria: 840-1227664-32
Telefon: 016/891-961
E-mail: kulturni.centar@medvedja.ls.gov.rs
Datan: 15.09.2025
Numër: 267-2/2025

Në bazë të nenit 24. Ligjit mbi punën ("Gz.zyrtare RS", numër. 24/2005, 61/2005, 54/2009, 32/2013, 75/2014, 13/2017 – vendimi GJ dhe 113/2017 dh 95/2018 – interpretim autentik), neni 37.neni 50., neni 51. dhe 52. të Ligjit për të punësuarit në shërbimet publike ("Gazeta zyrtare e RS", numër 113/17, 95/18, 86/19, 157/2020 dhe 123/2021), dhe neni 34. Statuti i qendrës Kulturore të komunës së Medvegjës ("Gazeta zyrtare e qytetit të Leskovcit", numër 8 nga 07.04.2023), dhe neni 4.paragrafi 6. Rregullorja për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Qendrën e kulturës të Komunës së Medvegjës numër 203/2020 nga viti 22.07.2021, Aktvendimit të kryetarit të komunës së Medvegjës për miratimin e Rregullores për organizimin dhe sistemin e vendeve të punës në Qendrën e Kulturës të komunës së Medvegjës 07 numër: 110-1/2020 nga viti 24. 07. 2020. Vendimet për plotësimin e Rregullores për organizimin dhe sistemin e vendeve të punës në Qendrën Kulturore të komunës së Medvegjës, plotësimet numër 72/2025 nga viti 20.02.2025, Aktvendim për miratimin e Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për organizimin dhe sistemin e vendeve të punës në Qendrën e Kulturës të komunës së Medvegjës, numër 000002482 2025 06154 002 000 016 012 04 026 nga viti 31.03.2025 është miratuar nga kryetari i komunës së Medvegjës, Vendimet e Komisionit për dhënien e pëlqimit për punësime të reja dhe angazhime shtesë pune me përdoruesit e mjeteve publike Konkludim 51 Numër: 112-8194/2025 nga viti 29.07.2025, Vendimi mbi Planin e Kadrovik të ndryshuar për vitin 2025 Numër. 80/2025 nga viti 28.02.2025 dhe Vendimi mbi zbatimin e konkursit publik për punësimin e një ekzekutuesi për një periudhë të pacaktuar kohore Numër. 267/2025 nga viti 15.09.2025, drejtori i qendrës Kulturore të komunës së Medvegjës shpall:

KONKURS PUBLIK PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS TË EKZEKUTUESIT

NË QENDRËN KULTURORE TË KOMUNËS SË MEDVEGJËS

I Institucioni ku po plotësohet vendi i punës:

Qendra kulturore e komunës së Medvegjës, rruga Gjure Jakshiq numër 6, 16 240 Medvegjë

II Vendi i punës që plotësohet: Organizator i aktiviteteve kulturore në fushën e folklorit, numri i ekzekutuesve 1, për një periudhë të pacaktuar kohore.

Përshkrimi i punës për ekzekutuesin është:

- organizon, udhëheqë, kontrollon dhe koordinon punën gjatë përgatitjes dhe zbatimit të projekteve/programeve në qendrën kulturore polivalente;
- përgatit, propozon dhe miraton plane për zbatimin e projekteve/programeve në qendrën kulturore polivalente;
- përgatit, zhvillon dhe zbaton programet vjetore të punës të përcaktuara;
- përgatit dokumentacionin për spedicionimin e mallrave gjatë vizitës jashtë vendit (karneti ATA);
- përpunon plan pune javor për zbatim;
- organizon provat; komunikon me udhëheqësit e grupeve dhe u cakton atyre detyra të menjëhershme
- punon me amatorë në fushën e artit folklorik;
- kryen prova të të vjetrave dhe merr pjesë në krijimin e rrjeteve të reja të lojërave, zakoneve dhe ritualeve
- koordinon punën e grupeve folklorike të shkollës
- ruan veshjen kombëtare dhe mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e saj
- organizon recensione, festivale, seminare, koncerte të shoqërive kulturore dhe artistike (KUD)

- mbledh materiale etnomuzikologjike nga zona e komunës së Medvegjës
- merr pjesë në animimin e anëtarëve të rinj të KUD-së
- kryen edhe detyra të tjera sipas urdhërave të drejtorit në përputhje me kualifikimet dhe aftësitë profesionale.

Kushtet: – arsim të mesëm, përvojë pune në çështjet kulturore të paktën 5 vjet

Kushtet e përgjithshme për të punuar në qendrën Kulturore të komunës së Medvegjës: që kandidati të ketë aftësinë shëndetësore (mendore dhe fizike) për të punuar në detyrat e pozicionit që plotësohet përmes konkursit, që ai/ajo të mos jetë dënuar ligjërisht me një dënim me burgim të pakushtëzuar prej të paktën gjashtë muajsh, që pjesëmarrësit në konkurs të mos i jetë ndërprerë më parë marrëdhënia e punës për shkak të një shkeljeje të rëndë të detyrës nga marrëdhënia e punës.

Në procesin e përzgjedhjes kontrollohen kualifikimet profesionale, njohuritë dhe aftësitë e kandidatëve dhe atë:

Aftësitë dhe kompetencat e kandidatit vlerësohen duke kontrolluar arsyetimin analitik dhe të menduarit logjik, aftësitë e komunikimit dhe aftësinë për të punuar me njerëz, nëpërmjet një simulimi të një problemi tipik që shfaqet në vendin e punës, të cilin kandidati duhet ta zgjidhë.

Verifikimi i aftësive ose kompetencave do të bëhet gojarisht.

III Vendi i punës:

Qendra Kulturore e Komunës së Medvegjës, rruga "Gjure Jakshiq" nr. 6, 16240 Medvegjë.

IV Afati për dorëzimin e aplikimeve në konkursin publik:

Afati për dorëzimin e aplikimeve është 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes së konkursit në publikimin "Posllovi" që publikohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

V Personi përgjegjës për dhënien e informacionit mbi konkursin publik: Dragisha Nikolliq, redaktor i programit në Qendrën Kulturore të Komunës së Medvegjës, zyra nr. 1, 016/3891-961

VI Adresa ku dorëzohet aplikimi për konkursin:

QENDRA KULTURORE E KOMUNËS SË MEDVEGJËS

Rr. Gjure Jakshiq nr. 6, 16240 Medvegjë, me shënimin: "Për konkursin për plotësimin e vendit të punës si Organizator i aktiviteteve kulturore në fushën e folklorit.

VII Data e shpalljes së konkursit në publikimin "Posllovi", 08.10.2025.

VIII Dëshmitë që bashkëngjiten me aplikimin në konkursin publik:

- aplikimi me biografi;
- certifikatë e lindjeje;
- certifikatë e shtetësisë;
- letërnjoftim i lexuar ose fotokopje e letërnjoftimit;
- dëshmi mbi arsimimin e fituar të shkollës së mesme;
- Certifikatë nga Ministria e Punëve të Brendshme - Drejtoria e Policisë që kandidati nuk është dënuar me burgim të pakushtëzuar për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh, dhe jo më e vjetër se gjashtë muaj;
- Vërtetim i gjykatës kompetente që kandidati nuk është nën hetim, jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Vërtetim për aftësinë shëndetësore (fizike dhe psikike)
- Dokumentet që dëshmojnë përvojën profesionale në fushën e aktiviteteve kulturore dhe njohuritë e fituara shtesë (certifikata, vendime dhe akte të tjera që tregojnë cilat detyra janë kryer, me cilin nivel arsimimi dhe në cilin periudhë është fituar përvoja profesionale, certifikata, vërtetime etj.)

Të gjitha provat paraqiten në original ose kopje të vërtetuar.

Aplikimi në konkurs duhet të përmbajë domosdoshmërisht të dhënat për pozitat e punës për të cilat kandidati aplikon dhe të dhënat për kandidatin (emri dhe mbiemri, adresa e qëndrimit ose e banuar, numri i telefonit të kontaktit të kandidatit, adresa e postës elektronike nëse kandidati disponon).

IX Vendi, dita dhe koha e verifikimit të aftësive profesionale, njohurive dhe shkathtësive të kandidatëve në procesin e përzgjedhjes:

Me kandidatët, të cilët kanë dorëzuar aplikimet e tyre në kohë, janë të lejuar, të kuptueshme dhe të plota, dhe kanë paraqitur të gjitha provat e nevojshme dhe plotësojnë kërkesat për pozitat e shpallura, do të kryhet verifikimi i njohurive dhe shkathtësive të caktuara në ambientet e Qendrës Kulturore të Komunës Medvegje, Rr. Gjyre Jakshiq nr. 6, më 23.10.2025, në orën 10:00. Kandidatët do të njoftohen për këtë nëpërmjet telefonit në numrin që kanë paraqitur në aplikim ose me shkrim përmes postës elektronike të paraqitur në aplikim.

X Për pozitën e punës që plotësohet përmes konkursit, marrëdhënia e punës krijohet në periudhë të pacaktuar kohore.

XI Konkursi rbatohet nga Komisioni i Konkursit i formuar me vendimin e drejtorit të Qendrës Kulturore të Komunës Medvegje nr. 267-1/2025 data 15.09.2025.

Shënim:

Aplikimet që janë të vonuara, të paqarta ose të pasakta dhe aplikimet për të cilat nuk janë paraqitur të gjitha provat e nevojshme në origjinal ose në kopje të vërtetuar në përputhje me rregulloret që rregullojnë vërtetimin e nënshkrimeve, dorëshkrimeve dhe kopjeve, do të refuzohen me aktvendim të komisionit të konkursit, kundër të cilit mund të bëhet ankesë te drejtor i Qendrës Kulturore brenda një periudhe prej 5 (pesë) ditësh nga data e marrjes së aktvendimit. Ky konkurs do të publikohet në tabelën e njoftimeve dhe në faqen e internetit të Qendrës Kulturore të Komunës Medvegje, si dhe në publikimin "Poslllovi" që botohet nga Shërbimi Kombëtar për Punesim.

* Të gjithë shprehjet, termat, emrat, mbiemrat dhe foljet në këtë shpallje që janë përdorur në gjininë mashkullore, i referohen pa diskriminim edhe personave të gjinisë femërore.



Drejtor

Nebojsha Jakshiq